

Kompania për furnizim me gaz në Pakistan sot e ka ndalur rrjedhjen e gazit në rezidencën

zyrtare të kryeministrit, Nawaz Sharif, dhe të sekretariatit të parlamentit, për shkak të faturave të

papaguara.

Një udhëheqës i kompanisë së gazit, e udhëhequr nga shteti, tha se kryeministria nuk e ka

paguar faturën prej 48 mijë dollarëve.

Faturat e borxheve për furnizim me gaz për sekretariatit të parlamentit, zyrat e ligjvënësve,

ndërtesën e gjykatës federale dhe ndërtesat e tjera qeveritare, arrijnë shumën prej 200 mijë

dollarëve, citon rel.

Këto shkurtime të furnizimit me gaz paraqesin vështirësi për kryeministrin Sharif, pasi ai javën e

kaluar i kishte urdhëruar autoritetet, që të jenë të ashpra me ata që nuk e paguanë gazin.

/Indeksonline